



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12 2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 04 qershor 2008, nenit 6 pika 1 paragrafi 1.2, nenit 21 paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 24 paragrafi 3, nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës datë 13.08.2020, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe duke u bazuar në shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.020-309/8 datë 15.05.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE GRACKË E VJETËR

Neni 1

1. Me këtë Vendim, i jepet në shfrytëzim për periudhën afatëgjatë prej 20 vitesh, prona komunale për ndërmarrjen-kompaninë publike Regjionale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Sh.A- Prishtinë, në parcelën kadastrale P-71409080-00256-0 me sipërfaqe prej 6570 m² me kulturë kullosë e klasës 3-të zona kadastrale Grackë e Vjetër, sipas kërkesës së datës 18.05.2023 ref 15Nr.462/01-25601 të Kompanisë Regjionale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Sh.A -Prishtinë.

Neni 2

Qëllim i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi është për ndërtimin e infrastrukturës teknike në ofrimin e shërbimeve administrative dhe shërbimeve të tjera si dhe për vendosjen e makinerisë për ushtrimin e veprimtarisë, që të krijohen kushtet (teknike) për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj qytetarëve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Inspekcion dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi fshihet pika 1.2 e nenit 1 të Vendimit 15Nr.463-44897 të datës 20.07.2018 për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut të kafshëve dhe vendosjen e tregut për produktet ushqimore për kafshë dhe lëndë djegëse në ZK Grackë e Vjetër dhe SHFUQIZOHET Vendimi 15Nr.463-44904 të datës 20.07.2018 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës Kompanisë Regjionale Pastrimi-Prishtinë, Njësia Operative në Lipjan.

Arsyetim

Baza ligjore për të propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021.

Arsyet e rishqyrtimit të Vendimit 15Nr.462/-1-16377 të miratuar me datë 31.03.2023 nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, janë si vijon:

Në shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.020-309/8 datë 15.05.2023, të pranuar nga Komuna me datë 18.05.2023 ref 15-462/01-25601, është njoftuar Komuna e Lipjanit se Vendimi 15Nr.462/-1-16377 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Grackë e Vjetër i nxjerr nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, nuk është në harmoni me nenin 21 paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 dhe nenit 24 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në

Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ku sqaron se kërkesa duhet të jetë e adresuar nga titullari-udhëheqësi i institucionit përkatës si dhe duhet të përcaktohet qëllimi i interesit publik i cili është harmoni të plotë me dokumentet e planifikimit hapësinor.

Me kërkesën e datës 18.05.2023 ref 15-462/01-25601 të Kompanisë Regjionale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Sh.A -Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme konkretisht parcelën kadastrale P-71409080-00256-0 me sipërfaqe 6570 m² ZK Grackë e Vjetër, me qëllim të ndërtimit të infrastrukturës teknike për ofrimin e shërbimeve administrative, shërbimeve të tjera si dhe për vendosjen e makinerisë për ushtrimin e veprimtarisë, me qëllim që të krijohen kushtet (teknike) për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj qytetarëve, për çka është detyrë dhe obligim i Kompanisë/ Ndërmarrjes.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e theksuara më lartë, në pajtim me dispozitat e cekura ligjore kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

INr. 462/01-25743
Lipjan, më 19.05.2023





DALEŠE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

No. 020-309/p
Data 15.05.2023

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administrancije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit		
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë		
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha , Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL		
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 12.04.2023 VI-020-309	
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti,Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim		
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Lipjanit		

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 15 Nr.462/01-16377 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Grackë e Vjetër
I miratuar më datë: 31.03.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.04.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2023, ka miratuar Vendimin 015 Nr.462/01-16377 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Grackë e Vjetër i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit është në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 24 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave për Dhënin në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të komunës, ku sqaron se kërkesa duhet të jetë e adresuar nga titullari-udhëheqësi i institucionit përkatës si dhe duhet të përcaktohet qëllimi dhe interesi publik i cili është në harmoni të plotë me dokumentet e planifikimit hapësinor.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, duhet që të ndërmerr veprime ta rishqyrtoj aktin 15 Nr.462/01-16377 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Grackë e Vjetër dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPJAN

Pranuar me:		
Priljeno: 18.05.2023		
Njesia Jednica	Num. Brez	Shtetja Dodatak
15-462/01-25601		

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
"PASTRIMI" SH.A
Nr. 1514 dt. 18.05.2023
Prishtine - Prishtine



Datë: 18 maj 2023

PËR: Z. IMRI AHMETI – KRYETAR I KOMUNËS SË LIPJANIT
Z. DAUT AZEMI – KRYESUES I KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT
NGA: KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE (KRM) "PASTRIMI" SH.A – PRISHTINË
Z. PETRIT REÇICA – KRYESHEF EKZEKUTIV
LËNDA: KËRKESË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Të nderuar,

Duke uruar të jeni mirë dhe punët t'ju ecin mbarë, përmes kësaj parashtrëse, në cilësi të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" Sh.A – Prishtinë, parashtoj kërkesën për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme në një zonë kadastrale, respektivisht në një lokacion të cilin e konsideroni të arsyeshëm, me një sipërfaqe rreth 6500 – 8000 m2.

Siç e dini, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2023, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka marrë vendim (Nr. 462/01-16377) për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonë kadastrale Grackë e Vjetër, të parcelës kadastrale P-71409080-00256-0, me sipërfaqe 6570 m2.

Ndërkaq, më datë 15.05.2023, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përmes kërkesës për rishqyrtim, ndër të tjera, ka theksuar se vendimi i lartcekur i Kuvendit të Komunës së Lipjanit nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, për arsye se kërkesa për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme nuk është parashtruar nga titullari/udhëheqësi i institucionit përkatës, respektivisht në rrethanat e rastit konkret, nuk është parashtruar nga KRM "Pastrimi" Sh.A.

Në këtë kuptim, bazuar në shkresën e cekur më sipër të MAPL-së, parashtoj këtë kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, duke kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, si organ kompetent për shqyrtimin dhe vendosjen e kësaj kërkesë, që në bazë të Ligjit

Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të merr vendim për aprovim si të bazuar të kësaj kërkesë, me qëllim të ndërtimit të infrastrukturës teknike për ofrimin e shërbimeve administrative dhe shërbimeve të tjera, si dhe për vendosjen e makinerisë për ushtrimin e veprimtarisë.

Sepse, përmes dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, ashtu siç u theksua edhe më sipër, do të krijoheshin mundësitë dhe kushtet (teknike) për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj qytetarëve, për çka edhe është detyrë dhe obligim i yni si kompani/ndërmarrje.

Për fund, duke marrë për bazë natyrën urgjente të shqyrtimit dhe vendosjes së kësaj kërkesë, pas mbledhjes së ardhshme të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit, mirëpresim vendimin që e njëjta të miratohet dhe aprovohet si e bazuar, respektivisht të merrret vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme.

Ju faleminderit paraprakisht për mirëkuptimin tuaj!

Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastrimi" Sh.p.k. të Prishtinës

Petrit Reçica

